



REPUBLIKA E KOSOVË
Drejtoria e Inspektionit
Glllogoc, me 07.05.2019



RAPORT PËR MUAJIN PRILL 2019

Gjatë këtij muaji të gjithë inspektorët kanë kryer punët sipas sektorëve përkatës, fillimisht në shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve dhe planit operativ të përpiluar për sektorin e komunikacionit për parandalimin e transportit ilegal –kombi-busve. Inspektimi në komunikacion është bërë së bashku me pjestarët e policisë së Kosovës-trafikut regjional dhe inspektorët MIT në magjistralen M9 në segmentin Krivovë-Arllat, dhe rruget regjionale të Drenasit.

SEKTORI SANITAR

Gjatë muajit prill është filluar me inspektim në të gjitha shkollat në Komunën e Drenasit, në përgjithsi është konstatuar një gjendje e mirë higjienike dhe teknike, në ato shkolla ku kemi hasur në parregullësi janë dhënë sugjerimet për përmirësim të kushteve. Pastaj janë inspektuar sallonet e ondulmit në Drenas dhe Komoran për kushtet higjienike, duke urdhëruar për tu pajisur me librezë sanitare dhe ngritje të nivelit të higjienës. Gjatë këtij muaji kemi pasur dy kërkesa të palëve dhe dy kërkesa për pëlqim sanitar për subjekte shëndetsore private.

SEKTORI I NDËRTIMIT

Janë inspektuar ndërtimet në Drenas, në veçanti ndërtimet pa leje në zonat e urbanizuara në afërsi të rrugëve regjionale dhe lokale, në zonën e tokës bujqësore nën masën e komosacionit dhe ndërtimet që bëhen në pronën komunale. Gjatë zhvillimit të procedurave janë hartuar procesverbale të inspektimit, aktvendime, njoftime dhe përgjigje ndaj kërkesave.

SEKTORI I KOMUNIKACIONIT

Gjatë kësaj periudhe, Prill 2019 është inspektuar në transport të udhëtarëve sipas Ligjit për transportin rrugor Nr.04/L179 dhe në bazë të Rregullorës së Komunës së Drenasit Nr.06/7086. Pikësynim kryesor gjatë kësaj periudhe ka qenë largimi i transportuesëve ilegal në veçanti kombi-busët të cilët ushtrojnë veprimtarinë transportuese të udhëtarëve pa licencë, që është në kundërshtim me rregulloren në fjalë. Janë inspektuar të gjitha kompanitë e licencuara për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave. Gjatë këtij muaji nuk kemi pas asistim nga Policia-Drenas për arsye të mungesës së stafit dhe angazhimeve të tyre të shumta. Sipas planit operativ të caktuar nga DI, kemi inspektuar me asistim të Policisë së Kosovës-Trafiku regjional dhe inspektorët e MIT.

SEKTORI I TREGUT

Janë inspektuar bizneset e reja të pa regjistruara, janë bërë shqyrtime të kërkesave për dhënjën e pëlqimit për ushtrimin e veprimtarisë, kontrollimin e artikujve ushqimor dhe afatet e përdorimit, inspektim në komunikacion me autorizim sipas planit për ndalimin e transportuesve ilegal.

SEKTORI I MJEDISIT

Janë realizuar inspekte në mjedis, janë shqyrtuar kërkesa të palëve , bizneseve për hyrje në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, identifikimin e deponive ilegale, si dhe inspekte rutinore për verifikimin e gjendjes mjedisore në teren.

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punës në shifra për muajin Prill 2019

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktvendime	Gjoba mandatore	Fletëparaqitje	Kërkesa për Pëlqim sanitar	Pëlqime Sanitare	Kërkesa	Shqyrtim i kerk.	Mbyllje të lokalev	Konfiskim i targave dhe automjeteve	Konfiskim i mallit pa afat
Sanitari	33	2	1	0	2	2	2	4	0	0	0
Treg	17	3	2	0	0	0	3	3	0	0	0
Komunikacion	9	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0
Ndërtim	42	2	3	1	0	0	1	1	0	0	0
Ambient	16		0	0	0	0	2	2	0	0	0
Totali	117	7	9	1	2	2	8	10	0	0	0

Prill,2019

U.D Shef i Inspektionit: Haki Bekolli